



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 3039/14 Prot.

Tiranë, më 14.11 2023

V E N D I M

Nr. 118 dt. 14.11 2023

“PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN E ORGANIZIMIT DHE
FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË MBARËVAJTJES SË
VEPRIMTARISË DHE MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT, NË UNIVERSITETIN E
SPORTEVE TË TIRANËS”

Mbështetur në nenet 33 paragrafi 3, 38, 46 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës” në nenin 20, 26 të Statutit të UST-së, në nenin 7 dhe 10 të Rregullores së UST-së, si dhe mbështetur në Vendimin nr.2, datë 19.10.2023 “Për ndryshime në Rregulloren e Funkcionimit të Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët” të Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët, shkresën nr.2866 Prot., datë 01.11.2023 të Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët, shkresën nr.2866/2 prot., datë 06.11.2023 të Drejtorisë Juridike dhe Zhvillimit të Kurrikulave, Senati Akademik në datën 14.11.2023.

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përherëshëm të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët, në Universitetin e Sporteve të Tiranës” (bashkëlidhur vendimit).
2. Ky vendim ti përcillet për njohje dhe publikim Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët, njësisive kryesore si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Sherbimeve Akademiko-Shkencore.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

**RREGULLORE
PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KOMISIONIT TË PËRHERSHËM,
NË NIVEL INSTITUCIONI,
TË MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT**

Miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 85 datë 14/05/2021
Ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 118 dt 14.11.2023

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm në nivel institucioni për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët e Universitetit të Sporteve të Tiranës si dhe bashkërendon marrëdhëniet e studentëve me organet e autoritetet drejtuese si dhe me gjithë strukturat e universitetit.

Neni 2

Baza Ligjore

Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët të Universitetit të Sporteve të Tiranës mbështetet në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të latë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, Rregulloren e universitetit dhe të gjitha aktet e tjera ligjore në fuqi.

Neni 3

Përkufizimi

Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët është organ kolegjal i ngritur pranë Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe shërben për të siguruar një nivel cilësor të mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe të bashkëpunimit të ngushtë me studentët.

Neni 4

Përbërja e Komisionit

4.1 Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë nga të cilët:

- 3 (tre) anëtarë janë staf akademik nga një përfaqësues për fakultet;
- 1 (një) anëtar I propozuar nga Rektori I UST-së;
- 1 (një) anëtar nga studentët.

4.2 Të gjithë anëtarët vetkandidohen dhe më pas përzgjidhen nga Senati Akademik me një mandat 2 (dy) vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

4.3 Mandati i anëtarëve të komisionit përfundon përpara kohës së përcaktuar kur:

- o *Për stafin:*
 1. Jep dorëheqjen;
 2. Largohe nga puna;
 3. Kur ka mospërputhje me detyrat e tjera që mund të marrë;
 4. Merr masë të rëndë disiplinore.
- o *Për studentin:*
 1. Jep dorëheqjen;
 2. Përfundon statusin e tij si student;
 3. Merr masë të rëndë disiplinore.

Neni 5

Mënyra e funksionimit

1. Mbledhja e parë e Komisionit thirret nga Rektori, në cilësinë e Kryetarit të Senatit Akademik.
2. Mbledhja e parë e Komisionit është e vlefshme kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij.
3. Komisioni zhvillon mbledhje periodike të paktën 1 (një) herë në muaj për periudhën 10 (dhjetë) mujore.
4. Kryetari, i cili përzgjidhet nga Senati Akademik nënshkruan aktet që miraton komisioni.
5. Kryetari vendos për datën dhe orën e mbledhjeve të rradhës, përveç rasteve kur vetë Komisioni ka vendosur ndryshe dhe drejton mbledhjet e këtij komisioni.
6. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve, rendi i ditës, së bashku me dokumentacionin shoqërues bëhen nëpërmjet postës elektronike, të paktën 2 (dy) ditë përpara datës së thirrjes së mbledhjes, si edhe njoftimeve nëpërmjet telefonit.
7. Komunikimi me anëtarët e komisionit dhe me institucionet e tjera bëhet me shkrim ose me anë të e-mailit.
8. Vendimet e komisionit janë të vlefshme kur janë të votuara nga 50% +1 të anëtarëve.
9. Raporti vjetor i komisionit quhet i miratuar kur është votuar me shumicë të cilësuar të anëtarëve.
10. Komisioni zgjedh mes anëtarëve të tij një Sekretar, që është përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve.
11. Proçes-verbali i mbledhjes mbahet nga sekretari i komisionit dhe firmoset nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.
12. Proçes-verbali i mbledhjes do të përmbajë informacion lidhur me vendin, kohën e fillimit të mbledhjes, rendin e ditës dhe ndryshimet e mundshme të ndodhura në të, anëtarët e komisionit prezent ose që mungojnë, personat e tjerë të thirrur për të marrë pjesë në diskutime të vecanta, rezultatet e votimit, konkluzionet e mbledhjes si dhe çdo informacion të diskutuar gjatë mbledhjes.
13. Sekretari ruan bllokun e proçes-verbaleve si dhe të gjithë dokumentacionin e komisionit.

Neni 6

Funksionet e Komisionit

- 1) Bashkërendon komunikimin midis strukturave të ndryshme të UST-së dhe studentëve.
- 2) Harton politikat për trajtimin e studenteve duke mbajtur në konsideratë mbledhjen e të dhënave nga studentët përmes Këshillave Studentore, pyetësorëve, raportimeve vjetore në lidhje me problematikat e tyre si dhe referimin tek organet dhe autoritetet drejtuese të UST-së për zgjidhjen e tyre.
- 3) Bashkëpunon me Këshillat Studentore, Këshillin e Karrierës dhe Alumni dhe stafin akademik.
- 4) Propozon mbështetjen financiare dhe logjistike të projekteve të studentëve.

- 5) Kërkon informacione të ndryshme nga njësite kryesore për probleme të studentëve.
- 6) Kërkon informacion nga organet përbërëse të institucionit për çështje dhe probleme të paraqitura nga studentët dhe organizmat e tyre.
- 7) Orienton studentët që në bashkëpunim me organet drejtuese të marrin pjesë në aktivitete sociale, kulturore, akademike dhe sportive.
- 8) Bashkërendon punën dhe bashkëpunon me Komisionet e tjera të Përhershme të ngritura në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
- 9) Harton dhe dërgon për miratim pranë Senatit Akademik të UST-së Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këtij komisioni.
- 10) Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga autoritetet dhe organet drejtuese të UST-së në kuadër të mbështetjes dhe mbrojtjes së studentëve.

Neni 7

Instrumentat

Komisioni për mbarvajtjen e veprimtarisë së tij, përdor metoda e mëposhtme:

- 1- Takim me fokus grupe
- 2- Takime periodike me Këshillat Studentorë në nivel Universiteti dhe në nivel të njësisive kryesore.

Neni 8

Bashkëpunimet

Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët mund të inkurajojë dhe propozojë bashkëpunime me institucione të tjera universitare dhe jo, për të dhënë dhe për të shkëmbyer eksperiencë nga më të mirat dhe për të mbështetur iniciativë bashkëpunimi në funksion dhe dobi të studentëve.

Neni 9

Hyrja në fuqi e Rregullores

Kjo Rregullore hyn në fuqi, pasi miratohet nga Senati Akademik.